



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1045 / Prot.
5

Tiranë, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 26, datë 28.03.2023

PËR

**“MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E PËRBASHKËTA TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE TË CIKLIT TË
TRETË “MASTER EKZEKUTIV”, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të neneve 3, shkronja ç), 47 dhe 49 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Vendimit të KM-së nr. 288, datë 21.05.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë” i ndryshuar; të neneve 49 dhe 51 të Statutit të UMT-së; të Rregullores së UMT-së; të nenit 4, pika1, shkronja m), të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Administrimit të UMT-së”, si dhe të Vendimit të Senatit Akademik nr. 21, datë 10.03.2023, në mbledhjen e datës 28.03.2023, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2023-2024, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Studentët e regjistruar në programet e përbashkëta të studimit, të cilët nuk përfundojnë programin përkatës të studimit apo nuk shlyejnë të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, brenda kohëzgjatjes normale të tij, do të trajtohen sipas përcaktimeve në marrëveshjet specifike

dhe rregulloret përkatëse të programeve të sipërcituara, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të institucionit.



MONIKA FIDA

ANIS THODHORJANI

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT YZEIRAJ